



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 03
Data 12. 03. 2008

P R O C E S V E R B A L

Mbledhjen e kryesoi:
Rrustem Mustafa, kryetar i Komisionit

Të pranishëm në mbledhje ishin:
Shkumbin Demalija, Emrush Xhemajli, Zafir Berisha, Eqrem Kryeziu, Agim Veliu,
Naim Maloku, Gani Geci dhe Zylfi Merxha

Mungoi: Bujar Bukoshi, Bojan Stojanovič

Nga zyra mbështetëse morën pjesë: Ibush Mujaj,
Antigona Ibraj, Nur Çeku, Biljana Petrovič

Vëzhgues të tjerë ishin: Armend Beka OSBE, Luis Moratinos-Munoz OSBE, Nexhat
Shatri Zyra Ligjore e Presidencës dhe Nora Veseli IDK

Mbledhja filloi në orën 11:00 në sallën N-225, në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës.

Mbledhja filloj me këtë rend dite:

RENDI I DITËS

- 1. Miratimi i rendit të ditës.**
- 2. Miratimi i procesverbalit të datës 14 shkurt 2008.**
- 3. Miratimi i raportit nga trajnimi komisionit me OSBE-në**
- 4. Miratimi i planit të punës së komisionit.**
- 5. Shqyrtimi i projektligjit për përdorimin civil të eksploziveve**
- 6. Plani për vizitë institucioneve të sigurisë**
- 7. Te ndryshme**

Pika e parë: Rendi i ditës u miratua pa vërejtje

Pika e dytë: U miratua, mirëpo në lidhje me këtë pikë pati vërejtje. Agim Veliu tha ky procesverbal më tepër është një lloj ekstrakti, por Naim Maloku bëri një ndërhyrje duke theksuar: ne kemi pasur një lloj trajnimi për hartimin e procesverbalit dhe ky staf është dalluar për hartimin më të mirë të procesverbalit. Ky nuk është transkript që të shkruhet çdo fjalë që flitet këtu, por ne si komision mund të kërkojmë që mbledhjet të mbahen në salla ku ka incizim në mënyrë që të kemi transkript.

-Rrustem Mustafa tha unë besoi se për mbledhjet e rregullta nuk është i nevojshëm transkripti.

-Emrush Xhemaqli propozoi që çështja e transkriptit të diskutohet në mbledhjen e ardhshme. Me këtë propozim u pajtuan edhe anëtarët e tjerë të komisionit.

Pika e tretë: Raporti nga trajnimi i Komisionit me OSBE-në u miratua pa vërejtje, por në lidhje me këtë trajnim kryetari i komisionit theksoi se unë nuk jam i kënaqur me pjesëmarrjen e anëtarëve në trajnim por besoi se herëve të tjera do të këtë një angazhim më të madh. Prandaj unë besoi se edhe në të ardhmen do të kemi bashkëpunim të mirë me OSBE-në.

Pika e katërt: Në lidhje me këtë pikë Kryetari i komisionit potencoi se plani i punës mund të ndryshoj varësisht prej dinamikës së punës që do ta kemi të gjithë ne prandaj hapi debat në lidhje me këtë plan.

Anëtarët e komisionit përgëzuan për ndarjen e balancuar të këtij plani por kishte edhe disa propozime.

-Shkumbin Demaliaj propozoi që në këtë plan të përfshihen rrethanat e jashtëzakonshme.

-Naim Maloku dha dy sugjerime. Njëra kishte të bënte me Ministrin e Punëve të Brendshme për të cilën propozoi që të përgatiten pyetjet që nga java e ardhshme në mënyrë që MPB të ketë hapësirë të mjaftueshme për ti sjell përgjigjet dhe një javë pas marrjes së përgjigjeve të organizohet dëgjimi publik. Ndërsa çështja e dytë ka të bëjë me vizitën në Parlamentin e Shqipërisë në muajin maj, unë jam për këtë vizitë por mendoj se duhet që tani të fillojmë me procedurën e organizimit të kësaj vizite.

-Zafir Berisha propozoj që aktivitetet e muajit korrik të kalojnë në muajin qershor sepse edhe muaji korrik më tepër llogaritet si muaj i pushimit të aktiviteteve të Kuvendit.

Plani i punës së komisionit u miratua me marrëveshjen që ky plan mund të ndryshohet me marrëveshjen e të gjithë anëtarëve të komisionit.

Pika e pestë: Në lidhje me Projektligjin për përdorimin civil të eksplozivëve kryetari i komisionit tha se ky projektligji është miratuar në parim nga Kuvendi dhe tash komisioni ynë është komision funksional për procedim të mëtutjeshëm. Në duhet të caktojmë një anëtar si referues dhe mendoj ta caktojmë z. Naim Maloku i cili ka shprehur vetë dëshirën për këtë. Anëtarët e komisionit u pajtuan që z.Naim Maloku të jetë referues i këtij projektligji.

-Naim Maloku pranoi të jetë referues dhe propozoi që deri me 10 prill të dorëzohen të gjitha amendamentet e propozuara nga anëtarët e komisionit.

Pika e gjashtë: Kryetari i komisionit z.Rrustem Mustafa në lidhje me planin për vizitë institucioneve të sigurisë tha se unë kamë parapa që të gjitha vizitat të kryhen

brenda muajit mars, prandaj kërkoj nga stafi që ta përgatit organogramin për këto vizita.

-Shkumbin Demaliaj propozoj që në këtë tabelë të përfshihet edhe niveli i bashkëpunimit me KFOR-in dhe policinë e UNMIK-ut. Mirëpo kryetari i komisionit theksoi se ne nuk kemi të drejt ti shtim në organogram institucionet që nuk na përgjigjen drejtpërdrejt.

-Naim Maloku propozoj që këtë muaj ti vizitojmë vetëm SHPK-në dhe MPB-në, sepse nuk është e mundur që këto vizita të kryhen brenda këtij muaji. Por kryetari i komisionit tha se, unë besoi se ne do ti kryejmë këto vizita brenda këtij muaji, mirëpo nëse nuk arrijmë ti përfundojmë mund ti vazhdojmë në muajt në vazhdim. Anëtarët e tjerë të komisionit u pajtuan me këtë propozim të kryetarit.

Pika e shtatë: Në lidhje me pikën të ndryshme kryetari i komisionit i njoftoi anëtarët se Ligji për Emrin Personal i miratuar nga Kuvendi i Kosovës është shpall nga PSSP-ja dhe ky ligj tani është nën monitorimin tonë. Gjithashtu propozoj që ti bëjmë disa rregulla për anëtarët e komisionit dhe për stafin në mënyrë që puna e këtij komisioni të jetë më efikase.

-Gani Geci në këtë pik potencoi se ne si deputet kemi marr një raport prej komisionit të pavarur për media në të cilin është cek mbyllja e televizionit të Mitrovicës, prandaj desha ta di se a e ka cenuar sigurinë e Kosovës dhe në çfarë mënyre dhe desha ta di se në çfarë baze ligjore është bërë mbyllja e televizionit të Mitrovicës? A e ka shkel ligjin komisioni i pavarur për media apo televizioni i Mitrovicës.

Në lidhje me këtë temë z.Rrustem Mustafa tha kjo është çështje që mund të diskutohet por nuk është çështje që është në objektivat tona prandaj nuk do të merremi shumë më këtë punë. Unë më tepër kam disa shqetësime për sigurinë në vend, jo qysh është tani por si do të jetë në të ardhmen, prandaj unë kam në plan që ti ftojme njerëzit që thirren për sigurinë në vend si p.sh Kryeministrin, Kryetarin, Ministrin e Punëve të Brendshme, Komandantin e SHPK-së, Komandantin e KFOR-it etj, dhe unë kisha deshtë mi pyet për funksionimin e shtetit dhe mendoj se këto shqetësime ne duhet mi orientuar në adresat ku duhet.

-Eqrem Kryeziu tha, unë pajtohem me shqetësimet e juaja dhe me propozimin për të krijuar një rend në mënyrë që të kemi punë efikase, mirëpo duhet të merren parasysh edhe justifikimet sidomos për ne anëtarët që udhëtojmë.

-Naim Maloku tha, në lidhje me këto shqetësime që ju i ngritët unë propozoi që ti diskutojmë në mbledhjen e ardhshme dhe në bazë të kompetencave që ne i kemi si komision të hartojmë një plan se si të veprojmë.

-Shkumbin Demalija lidhur me format e organizimit mendoj se nuk duhet të kemi rregulla strikte sepse ne të gjithë jemi deputet dhe i dimë përgjegjësit tona, por unë mendoj se ne duhet ti ndajmë detyrat në komision dhe më pas ti raportojmë kryetarit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10

Kryetari i Komisionit
Rrustem Mustafa

